# Analiza&Komente

## Shqiptarët dhe dy historitë e ndryshme komuniste

Çështja nëse shqiptarët kanë identitet të përbashkët kombëtar është ende në debatim e sipër dhe për të nuk ka një pajtueshmëri të përgjithshme. Në fund të fundit, çështja e identitetit është e problematizuar edhe ndër filozofë shumë të mëdhenj të ditëve të sotme, si Judith Butler, Charles Taylor, Amin Malouf e shumë të tjerë. Megjithatë, është e qartë se ka një vijimësi në identifikimin e shqiptarëve të Kosovës si shqiptarë. Sidoqoftë, po e marrim si të mirëqenë këtë identitet në mënyrë që ta problematizojmë çështjen e "historive të ndryshme komuniste" dhe relacionit të saj me narrativen e mëpastajme që e ravijëzon të ardhmen tonë.

Kosova pas Luftës së II botërore mbeti pjesë e ish-Jugosllavisë dhe nuk u bashkua me Shqipërinë ashtu siç kërkonte Konferenca e Bujanit. Kësisoj, shqiptarët e Kosovës nuk e pësuan dhunën e papërmbajtshme shtetërore që e kreu Enver Hoxha. Nuk ishin pjesë e shtetit më të izoluar në identitetin tonë, pra shqiptarët e Shqipërisë, e kishin një të kaluar edhe më represive e shtypëse.

Të ndalemi në këtë pikë. Nuk është e mundur t'ia sajosh vetes një imazh krejt human duke i mbyllur sytë ose duke e hequr nga mendja faktin e lartpërmendur që vetë shqiptarët në një shtet shqiptar e organizuan një skemë dhune e shtypjeje me qëllim instalimin e një ideologjie komuniste. Komunizmi shqiptar ishte aq i rreptë dhe ngulmues në versionin e tij të komunizmit sa vrau e persekutoi secilin që thjesht mendonte ndryshe. Shqipëria nuk e kishte asnjë disident, ndërsa Jugosllavia i kishte qindra të tillë. Po ashtu, Shqipëria komuniste njihej si një vend fund e krye totalitar, që bënte gjithçka për t'i çrrënjosur dhunshëm sferat e painstitucionalizuara të pushtetit: moralin shoqëror, kanunin, pak më vonë edhe fenë (sado që kjo ruan një lidhje nënshtrimi me shtetin) etj. Pra, edhe shqiptarët mund të vrasin dhe të kryejnë krime.



Jetlir Buja

"Sallonet e së martës" janë një nismë javore e institutit "Demokraci për Zhvillim" (D4D). Salloni ka format gjysmëformal, sipas rregullës "Chatham House" dhe pa prani të medieve. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë, politikanë e publicistë për të reflektuar dhe për të kërkuar konsensus mbi temat



LEADERSHIP and INNOVATION
Education | Research | Training | Consulting | Certification

PROGRAMET E AKREDITUARA

SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI
• Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
• Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
• Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
• Web Programim
• Rrjeta dhe Telekomunikacion
• Robotikë dhe Sistemet Intelegjente
• Informatikë Biomjeksore
• Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
• Multimedia dhe Vizualizim
• Inxhinieri e Komunikimit
• Shkenca e të Dhënave Statistikore
• Informatikë Mjeksore

MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI
• Financa, Banka dhe Sigurime
• Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
• Marketing dhe Shitje
• Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
• Biznes Ndërkombëtar
• Logjistika dhe Menaxhim i Prokurimit

MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT
• Menaxhim i Mekatronikes
• Automatizimi Industrial dhe Kontrolli i Procesit
• Dizajn i Produkteve Industriale
• Robotikë dhe Sisteme Intelegjente
• Inxhinieri Biomjeksore
• Inxhinieri e Telekomunikacionit
• Inxhinieri Mekanike
• Inxhinieria e Aeronautikes
• Dizajn i Produkteve Industriale
• Inxhinieri e Proceseve të Prodhimit

SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT
• Sistemet e Informacionit të Biznesit
• Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
• Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
• Statistikat, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
• Siguria e Informacionit dhe Privatësia
• Komerci Elektronik (E-Komerci)

ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR
• Arkitekturë e Qendrueshme
• Menaxhim Urban
• Restaurim Arkitekturor
• Dizajn i Interierit

e më të varfër në Evropë. Gëzuan arsimim më të mirë, të drejta të barabarta me kombësitë tjera (të paktën deri në kohën kur pushteti u mor nga Millosheviqi), të drejta mbi pronën e tyre, më vonë edhe autonomi (prej 1974 deri në suprimimin e saj më 1989) dhe u zhvilluan më hovshëm ekonomikisht, siç nuk do të ndodhte nëse do të ishin pjesë e sistemit hoxhist.

Pra, shqiptarët (e Kosovës dhe të Shqipërisë) i kanë dy histori të ndryshme komuniste. Dy pasqyra nga të cilat mund ta shohin veten nëse ia parakuptojnë e paramendojnë një identitet të përbashkët kombëtar a etnik, a çfarëdo qoftë, që ka pikëprekje me realitetin politik. Sidoqoftë, shkaku i ndikimeve që kishin narrativet për historinë, kjo nuk e ndalon një shqiptar nga Kosova që edhe sot të thotë "që serbët duke qenë serbë kryen krime mbi ne". Është evidente se një shoqëri e shtypur ka nevojë për një fajtor të dukshëm në mënyrë që ta derdhë urrejtjen e saj. Kjo bëhet që urrejtja të kanalizohet dhe mos ta ketë adresën e saj konkrete. Përdorimi i urrejtjes është bërë gjithnjë përgjatë historisë. Por, a është ky fajtorizim, njëmend fajtorizim? Aspak. Madje krejt e kundërta. Ta bësh një përgjithësim të tillë nënkupton jo thjesht të bëhesh racist, por edhe t'i përjashtosh nga fajësia fajtorët e vërtetë: individët ose ligjërimet urrejtjendjellëse. Po ashtu ky përgjithësim e dëfton mosmarrjen parasysh të faktit që ata që i fusim

Edhe shqiptarët mund të shtypin dhe të jenë të padrejtë ndaj njëri apo tjetrit po të kenë mundësi. Ose, ndoshta është e rrugës t'i heqim fare nga përdorimi "shqiptarët" dhe "serbët". Sepse kjo nuk ka lidhje me asnjërin prej të dyve. Kjo ka lidhje me të qenët populist, urrejtjendjellës e i dhunshëm. Ky është mësimi që mund ta marrim menjëherë sapo t'i shqyrtojmë këto dy histori të dhimbshme dhune dhe emancipimi.

Komunizmi ka provuar t'i lidhë njerëzit me vargonjtë e ideve dhe bindjeve të tyre dhe kësisoj ka ndërhyrë ashpër në mënyrën sesi mendonin e ndienin. Komunizmi shqiptar ushtronte kontroll të plotë madje edhe mbi kinematografinë dhe letërsinë e prodhuar. Dhe në një masë më të vogël këtë e bënte edhe komunizmi jugosllav. Sidomos në mostolerimin e bindjeve nacionaliste mes të dyja shoqërive. Njësimi i rrethanave politike, ligjërimeve e individëve nga narrativet historike bëhet për arsye politike. Me shembjen e Jugosllavisë ligjërimet nacionaliste në të gjitha shtetet përbërëse të saj u forcuan. U paraqitën si alternativa çliruese. Është më e zorshme të mendohet historia pa konceptet religjioze të "së mirës" dhe "së keqes". Sidomos nëse këto nuk ia atribuojmë tjetrit si një subjekt nga i cili buron njëra ose tjetra. Por, një shkëputje nga një kuptim i tillë i historisë është i domosdoshëm në mënyrë që të mos mbillet më shumë urrejtje e potencë për dhunë.

e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në kanalin e salloneve, në "YouTube". Secili Sallon përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-se. Podcastet bazuar në editorial mund t'i gjeni në uebfaqen tonë.


**INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË**
- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhimi i Ndërtimtarise dhe Teknologji
- Infrastrukturë Rrugore
- Inxhinieri e Ujerave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikes
- Inxhinieri e Materialeve

**SHKENCA POLITIKE**
- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integrime Evropiane
- Administratë Publike

**JURIDIK**
- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

**E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE**

**MEDIA DHE KOMUNIKIM**
- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhëniet me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

**POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM**
- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

**INXHINIERI E ENERGJISË**
- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Eklektikë Elektronike
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

**INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇIENTE**
- Burimet e Energjisë
- Konzervimi i Energjisë
- Eficienca e Energjisë
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieri Elektrike
- Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes
- Energjia Gjeotermike

**INFERMIERI**

**DIZAJN I INTEGRUAR**
- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstil
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

**SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI**
- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

**Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko**
**Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400,**
**Email: info@ubt-uni.net**